

RAPORT I AUDITUSIT
MBI AUDITIMIN E SHPENZIMEVE TË PARTISË LIGJ DHE DREJTËSI

Adresuar : **KOMISIONIT QËNDROR ZGJEDHOR**
Rruga " Dëshmorët e Kombit" Pallati i Kongreseve
TIRANË.

Të nderuar zotërinj

Unë, Lumturi Brahaj në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Autorizuar(Auditor i pavarur) jam caktuar me urdhërin nr. 4110 date 16.09.2009 të Kryetarit të K.Q.Z. Zt.Arben Ristani si dhe Kontratës së Shërbimit të dates 18.09.2009, për kryerjen e auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partisë Ligj dhe Drejtësi.

Ne kemi audituar pasqyrat bashkalidhur që lidhen me financimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore që fillon në datë 25.05.2009 dhe mbyllet më datë 25.06.2009.

Përgatitja e këtyre pasqyrave është përgjegjësi e drejtusve të Partisë Ligj dhe Drejtësi. Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin tonë.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Nderkombetare të Auditimit ,me referencë të veçantë SNA 800(raporti i auditorit për angazhime auditimi me qëllime të veçanta) Këto standarte kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të zotëruar siguri te arsyshme, se këto pasqyra nuk përmbajnë anomali materjale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve që mbeshtesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare të arkëtimit -pagesave.

Auditimi përfshin gjithashtu , vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës së arkëtimit -pagesave.

Ne çmojmë se auditimi ynë përbën një bazë të arsyeshme për të shprehur opinionin tonë.

Politika kontabël e ndjekur nga ana e subjektit zgjedhor Partia Ligj dhe Drejtësi është të përgatisë pasqyrat bashkalidhur mbi bazën e arkëtimit dhe pagesave. Mbi këtë bazë , e ardhura është njohur ne montin e arkëtimit dhe shpenzimet në momentin e pagesave.

Per mendimin tonë , pasqyrat bashkalidhidhur japin një pamje të vërtetë e të sinqertë të fondeve të arkëtuara dhe të shpenzuara nga subjekti zgjedhor Partia Ligj dhe Drejtësi gjatë fushatës elektorale që hapet më 25.05.2009 dhe mbyllet më 25.06.2009, në përputhje me bazën e arkëtimit dhe pagesave , siç përshkruhet në shënimet bashkalidhur.

Raporti u hartua mbështetur në pasqyrat e të ardhurave e shpenzime dhe në pasqyrën e fondeve të përfituara në fushatën zgjedhore nga persona fizik e juridik për Partin Ligj dhe Drejtësi.

Eksperte Kontabël e Autorizuar

Lumturi Brahaj-

Tiranë më, 31 Tetor 2009

PARTIA LIGJ DHE DREJTËSI

**PASQYRA E ARKËTIMEVE PAGESAVE TË BËRA PËR FUSHATËN ZGJEDHORE
TË 28 QERSHORIT 2009**

| Përshkrimi | Lekë | Fatur nr,date |
|---|----------------|---------------------------|
| A- Të Ardhurat | 592 100 | |
| Fondi financiar nga buxheti për fushatën zgjedhore | 0 | |
| Fondi i dhënë në momentin e krijimit partisë | 100 000 | |
| Fonde të dhuruara nga persona fizik për fushatë | 0 | |
| Fonde të përftuara nga persona Juridik për fushatë | 492 100 | NIPTI K 31901005 I |
| Totali të ardhurave,burimeve,(arkëtimeve) | 592 100 | |
| B- SHPENZIME PËR FUSHATËN (deri më 25.06.2009) | 492 100 | |
| 1-Platea sh.a .Hapësire Publicitare | 52 400 | Nr,139.dt.15.06.09 |
| 2-Metro sh.a.Hapësire publicitare | 77700 | Nr.140.dt.22.06.09 |
| 3-Rreli shpk . fotografi | 32000 | Nr. 95.dt.25.05.09 |
| 4-Dita 2000 shpk -shtypshkrime- | 13000 | Nr.239.dt.07.05.09 |
| 5- Abstract Stamp – stampime për publicitet | 18000 | |
| 6-Qera ambjenti e zyre. | 299000 | Kont.nr,1118rep, 380kl |
| Totali shpenzimeve | 492 100 | |

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SUBJEKTIN ZGJEDHOR

Subjekti zgjedhor "Partia Ligj dhe Drejtësi" e ka fituar zotësinë juridike për të vepruar, me vendim Nr.1118 datë 17.02.2009 të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit Nr. 8580 datë 17.02.2000

"Për Partite politike" neni 9, 10, 11 e të tjerë.

Qëllimi dhe objektivat e kësaj Partie gjejnë pasqyrim të qartë në Programin dhe Statutin e saj.

Subjekti zgjedhor "Partia Ligj dhe Drejtësi" është një bashkim politik i qytetarëve shqiptarë e cila e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë.

Kapitali themeltar i Qendrës është shuma prej 100.000 leke (njqindmije)

Qendra e Partisë Ligj dhe Drejtësi është në Tiranë.

Selia e Partisë Ligj dhe Drejtësi ishte te Bulevardi Dëshmorët e Kombit Kullat Binjake.

Objekti i veprimtarisë :

Qëllimi i Partisë Ligj dhe Drejtësi është të forcojë eksperiencën politike demokratike në Shqipëri duke promovuar vlera demokratike.

Burimet e financimit janë :

- Buxheti i Shtetit financuar për fushatë zero (0) lekë.
- Fonde të dhëna nga buxheti në momentin e krijimit të Partisë Ligj e drejtësi 100 000 lekë.
- Donacionet dhe dhuratat. 492 100 lekë.
- Si dhe burime të tjera të ligjshme sipas legjislacionit shqiptar. Zero.(0)

Burimet financiare janë përdorur drejtpërsëdrejti për të realizuar qëllimet dhe objektivat e subjektit zgjedhor.

Organet drejtuese të Qendrës janë :

Kuvendi Kombëtar
Asambleja Kombëtare
Kryesia e Partisë
Kryetari i Partisë
Kryetari Asamblesë Kombëtare
Sekretaria

Kryetar është zgjedhur Zt, Spartak Ngjelai.

Partia ka vulën ,logon, flamurin dhe stemat e saj.

1. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL

a. Mënyra e Prëgatitjes së Pasqyrave Financiare.

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar , të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 „Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare“ , të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pasqyrat e paraqitura në raport janë shprehur në monedhën vendase në Lekë .

a. Rregullat për vlerësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Të ardhurat regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre nga donatorët dhe përdorimi i tyre është sipas planit të buxhetit të financuar.

Të Ardhurat.

Të ardhurat janë të pasqyruara mbi bazën e arkëtimit të burimeve të financimit të vëna në dispozicion të Partisë Ligj dhe Drejtësi. Këto arkëtime janë bërë në bankë edhe në arkë, respektivisht ,në bankë janë pasqyruar fondi i dhënë nga buxheti në momentin e krijimit të subjektit Partisë Ligj dhe Drejtësi në shumën 100 000 lekë , ndërsa në arkë janë arkëtuar 492 100 lekë që janë donacione nga persona Juridik konform rregullave të cilat tërësisht janë përdorur për fushatën zgjedhore të 28 Qershorit 2009.

Detyrimet, ose Shpenzimet janë njohur dhe pasqyruar mbi bazën e faturave tatimore , mandat arktimëve dhe mandat pagesave dhe dokumentave orgjinale kontabël.

Masa e shpenzimeve të kryera është e vogël dhe është e lidhur me burimet që gjithashtu ishin të vogla.

Të gjitha shpenzimet janë bërë nga arka dhe jo nëpërmjet llogarisë bankare, megjithëse shumat e paguara janë më të vogla se kufiri i vënë nga organet fiskale dhe që nuk përbën shkelje, do të ishte mirë që në të ardhmen veprimet të kryhen nëpërmjet llogarisë bankare.

Këtu nuk janë përfshirë shpenzimet e bëra nga kandidatët për të cilat nuk disponoheshin dokumenta që të vërtetonin kryerjen e këtyre shpenzimeve mbasi ato nuk kanë kaluar në llogarinë e Partisë Ligj dhe Drejtësi.

Të gjitha shpenzimet e bëra për fushatën zgjedhore të 28 Qershorit 2009 nga Partia Ligj dhe Drejtësi janë përballuar nga Studio Legale T-Finance shpk me nr. NIPTI K 31901006 I , e cila është dhe donatorja e vetme e Partisë Ligj dhe Drejtësi.

Këto donacione janë dhënë për shlyerjen e faturave të rregullta tatimore sipas kushteve të rëna dakort në kontratat respektive të lidhura për çdo shpenzim të faturuar. Arkëtimi i donacioneve është bërë pjesë pjesë në përputhje me shumën e secilës faturë që është likuajduar.

Shuma prej 492 100 lekë i është dhënë Partisë Ligj dhe Drejtësi në momentin e likuajdimit të shpenzimeve në masën e vlerës së faturës, pra kjo shumë është dhënë jo e gjitha njëherësh po në masën e shpenzimeve të faturuara e të likuajduara, të cilat janë të gjitha më të vogla se 100 000 lekë që është edhe kufiri i lejuar për tu arkëtuar nga arka. Do të ishte më mirë që e gjithë shumta e dhënë nga Studio Legale T-Finance shpk me nr. NIPT-ti K 31901006 I të ishte depozituar e gjitha më parë në llogarinë bankare e më pas të bëhej likuajdimi respektiv i faturave.

Likuajdimi i faturave është bërë nga, arka kesh në dorë, ose nga arka duke i transferuar në llogarinë bankare të subjektit sipas kushteve të rënë dakort.

Vetë llogarija bankare e Partisë nuk është përdorur për likuidimin e shpenzimeve.

b. Rregullat e vlerësimit të likuiditeteve

Gjendjet e likuiditeteve përfshijnë gjendjen e parave në arkë dhe në llogaritë rrjedhëse në bankë në lekë.

U kontrolluan veprimet e kryera në arkë dhe bankë dhe u konstatuan se vlerësimet e veprimeve në valut janë bërë me kursin në ditën që janë kryer.

ORGANIZIMI I KONTABILITETIT

Kontabiliteti ishte i organizuar në përputhje me ligjin "Mbi Kontabilitetin".

Gjatë periudhës së ushtrimit të kontrollit nga ana jonë rezultoi se nuk kishte një person që të mbante llogarinë e saj. I gjithë dokumentacioni fatura, kontrata pagesa janë mbajtur nga donatori i saj kryesor që është "Studio Legale T- Finance"

Mbetet për tu përmirësuar në të ardhmen evidentimi i të gjitha shpenzimeve panvarsisht se kush i ka financuar.

Të gjitha donacionet duhet të bëhen hyrje në llogarinë e këtij subjekti dhe të gjithë shpenzimet e bëra prej tij duhet të dokumentohen me fatura të rregullta.

Tiranë më, 31 Tetor 2009